

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Numri i Prokurimit	207-26-4023-2-1-1
---------------------------	--------------------------

Sa i përket tenderit për: Shërbimet e transportit ajror – bileta për nevojat e MKT-së dhe Institucioneve Vartëse – Ri Tender

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Emri i Kompanisë: AS Travel Club Sh.P.K

Adresa : Rr. Tringe Smajli Nr. 6, Prishtinë

Numri Telefonit: 044-158 544

Emri i plotë i përfaqësuesit (te autorizuarit) të kompanisë suaj: Flamur Bahtijari

Adresa elektronike: info@astravel.com

Data e parashtrimit të ankesës: 07.08.2026

Nënshkrimi dhe vula: _____



**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË. Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimt të ankesës)(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” apo “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

1. Njoftimi për Kontrate:27.05.2026
2. Dosja e Tenderit: 26.05.2026
3. Lista e Përshkrimit të Çmimeve: 26.05.2026
4. Sqarime për Operatoret Ekonomik: 15.06.2026
5. Procesverbal i Hapjes së Tenderëve: 18.06.2026
6. Formularin B47- Letër Standarde e Kërkesës për Sqarime të Tenderit për OE: Prime Tours & Travel SH.P.K -18.06.2026
7. Kërkesë për Plotësim të Dokumenteve për OE: Prime Tours & Travel SH.P.K – Deshmite nga Gjykata dhe Administrata Tatimore : 23.06.2026
8. Raporti i Vlerësimit të parë të Ofertave ku është rekomanduar që të shpërblehet OE :Prime Tours & Travel SH.P.K: 24.06.2026
9. B58- Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – ku me kontrate ka rekomanduar që të shpërblehet OE :Prime Tours & Travel SH.P.K. 24.06.2026
10. Kërkesa për qasje në dokumentet e tenderit të dërguar nga OE : AS TRAVEL CLUB SH.P.K të Autoritetit Kontraktues:24.06.2026
11. Lejimi i qasjes nga Autoriteti Kontraktues me datën 24.06.2026
12. Kërkese për Rishqyrtim e dërguar nga OE : AS TRAVEL CLUB SH.P: 28.06.2026
13. Vendim për Pezullim të aktivitetit të prokurimit:29.06.2026
14. Vendimi i AK- për pranim - Pjesërisht të Bazuar të Kërkesës për Rishqyrtim të OE : AS TRAVEL CLUB SH.P :30.06.2026
15. Raporti i Vlerësimit të dytë të Ofertave ku është rekomanduar që me kontrate të shpërblehet OE: AS TRAVEL CLUB SH.P.K ka datën e shënuar **01.07.2026** ndërsa është nënshkruar nga komisioni i vlerësimit dhe aprovuar nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit me datën **08.07.2026**
16. B58- Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – ku me kontrate ka rekomanduar që të shpërblehet OE : AS TRAVEL CLUB SH.P.K: 08.07.2026
17. Kërkese për Rishqyrtim e dërguar nga OE :Prime Tours & Travel SH.P.K. 13.07.2026
18. Vendimi i AK- për pranim të Bazuar të Kërkesës për Rishqyrtim të OE :Prime Tours &

Travel SH.P.K: 15.07.2026

19. Raporti i Vlerësimit të trete të Ofertave ku është rekomanduar që të shpërblehet OE :Prime Tours & Travel SH.P.K: 21.07.2026
20. B58- Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – pas vlerësimit të trete të Ofertave ku është rekomanduar që me kontrate të shpërblehet OE :Prime Tours & Travel SH.P.K. 21.07.2026
21. Kërkesa për qasje në dokumentet e tenderit të dërguar nga OE : AS TRAVEL CLUB SH.P.K të Autoritetit Kontraktues:21.07.2026
22. Lejimi i qasjes nga Autoriteti Kontraktues me datën 22.07.2026
23. Kërkesa për qasje në dokumentet shtese te tenderit të dërguar nga OE : AS TRAVEL CLUB SH.P.K të Autoritetit Kontraktues:24.07.2026
24. Lejimi i qasjes nga Autoriteti Kontraktues me datën 24.07.2026
25. Kërkesë për Rishqyrtim: 25.07.2026
26. Vendim për Pezullim të aktivitetit të prokurimit:27.07.2026
27. Njoftim për OE për shtyrje të afatit për shqyrtim të Kërkesës për Rishqyrtim:28.07.2026
28. Vendimi i AK- për refuzim si të pa bazuar të Kërkesës tone për Rishqyrtim - OE : AS TRAVEL CLUB SH.P.K :30.07.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po	☐				Jo	☒	
----	--------------------------	--	--	--	----	-------------------------------------	--

Hapja e ofertave është bere në mënyre elektronike me datën 18.06.2026 në ora 14:00

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	☒				Jo	☐	
----	-------------------------------------	--	--	--	----	--------------------------	--

Autoriteti Kontraktues **pas vlerësimit të trete të ofertave** – me datën **21.07.2026** në platformën e E-Prokurimit ka bere publikimin e Formularit Standard B58- Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – **ku prape në kundërshtim të plote** me legjislacionin primar dh sekondar të prokurimit publik të aplikueshëm në Republikën e Kosovës ka rekomanduar që me kontrate të shpërblehet **OE:Prime Tours & Travel SH.P.K.**

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

☒

Jo

☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Me datën **25.07.2026** përmes platformës së e-prokurimit kemi dërguar Kërkesën për Rishqyrtim të Autoriteti Kontraktues – MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK.

Me datën **30.07.2026** përmes platformës së E-prokurimit kemi pranuar përgjigjeje – Vendimin nga Autoriteti Kontraktues **për refuzim si të pa bazuar të kërkesës ton për rishqyrtim**. Në këtë Vendim Autoriteti Kontraktues ka shënuar se ka marrë vendim që të mbetet në fuqi Vendimi i AK i datës **21.07.2026** për shpërbllim me kontratë të **OE: Prime Tours & Travel SH.P.K.**

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet e dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92, (LPP), janë:

Neni 59- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve;

Neni 72- Dokumentacioni dhe informacioni shtesë;

Shkeljet e dispozitave- RREGULLORE NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK (RRPP) janë:

Neni 38 - Sqarimi i Tenderëve

Neni 40- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve;

Neni 63 paragrafi 63.1.3 pika (a) - Vendimi i Autoritetit Kontraktues

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Pretendimet ankimore - Shkeljet e nenit 59 dhe 72 të LPP si dhe nenit 38, 40 dhe nenit 63 paragrafi 63.1.3 pika (a)- të RREGULLORËS NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK (RRPP)

Komisioni i Vlerësimit të trete të ofertave gjate fazës së vlerësimit të trete të ofertave dhe Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit gjate marrjes së vendimit për aprovim të **Raportit të trete** të vlerësimit të ofertave kane bere shkelje esenciale të **nenit 59 dhe 72 të LPP** si dhe **nenit 38, 40 dhe 63** të RREGULLORËS NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK (RRPP).

Pretendimi ankimor nr.1:

Autoriteti Kontraktues- MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK në Njoftimin për Kontrate të neni III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar dhe në Dosjen e Tenderit – Fleta e të Dhënave të Tenderit(FDT) neni 8.1&8.2, ka kërkuar, citojmë:

“**Kërkesa numër 2.** Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar realizuar me sukses shërbime të ngjashme shitjes së biletave të aeroplanit gjatë tri viteve të fundit (duke filluar nga data e publikimit të këtij njoftimi për kontratë), qarkullimi duhet të jetë jo më i vogël se 1,000,000.00 €.

2. Kopje e dëshmive të pagesave (Raport të transfereve) që janë bërë nga operatori ekonomik për blerjen e biletave nga avion kompanitë përkatëse apo sistemi kompjuterik i rezervimit ose burime apo çfarëdo dëshmie tjetër që dëshmojnë lehtësisht qarkullimin e kërkuar.”- **mbarim i citatit**

Operatori Ekonomik: Prime Tours & Travel SH.P.K. të cilin Autoriteti Kontraktues edhe pas **vlerësimit të trete** të ofertave prape e ka rekomanduar që të shpërblehet me kontrate, së bashku me ofertën e datës **27.05.2026**, nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi sa i përket Kërkesës numër 2, ashtu siç i ka kërkuar Autoriteti Kontraktues në Njoftimin për Kontrate dhe Dosje të Tenderit të Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT) - **Kopje e dëshmive të pagesave (Raport të transfereve)** që janë bërë nga operatori ekonomik për blerjen e biletave nga avion kompanitë përkatëse apo sistemi kompjuterik i rezervimit ose burime apo çfarëdo dëshmie tjetër që dëshmojnë lehtësisht qarkullimin e kërkuar.

Komisioni i Vlerësimit të **pare të Ofertave** në përbërje: **Yllka Syla, Ilirian Mekani dhe Leotrim Spahiu**, menjëherë pas hapjes së ofertave, konkretisht me datën **18.06.2026**, kane dërguar të OE: Prime Tours & Travel SH.P.K, Formularin B47- Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit.

(Dëshmia: Formularin B47- Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit i datës 18.06.2026)

Në këtë kërkesë Zyrtaret e Autoriteti Kontraktues që janë emëruar në komisionin e vlerësimit të ofertave përveç tjerash kane shënuar, **citojmë** :

*“Bazuar në dokumentacionin që keni ofruar në dosjen e tenderit, me konkretisht në listën e referencave/kontratave të realizuara, sic kërkohen në kërkesën numër 2, poashtu dhe dëshmia që kërkohet: **2. Kopje e dëshmive të pagesave (Raport të transfereve) që janë bërë nga operatori ekonomik për blerjen e biletave nga avion kompanitë përkatëse apo sistemi kompjuterik i rezervimit ose burime apo qfarëdo dëshmie tjetër që dëshmojnë lehtësisht qarkullimin e kërkuar. Me këtë kërkojmë që të plotësoni dokumentacionin sipas tabelës së Referencave/kontratave ashtu sic kërkohen tek dëshmia e kërkuar dokumentare.**” përfundim i citatit.*

Në përshkrimin që Komisioni i **parë** i Vlerësimit të ofertave ka bërë në Formularin B47- Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit të datës **18.06.2026**, konkretisht fjalë: *“Bazuar në dokumentacionin që keni ofruar në dosjen e tenderit, me konkretisht në listën e referencave/kontratave të realizuara, sic kërkohen në kërkesën numër 2”*, me së miri shpërfaqë **tendencën** e Komisionit të Vlerësimit të **pare** të ofertave për të **manipuluar dhe ndryshuar kriterin - kërkesën nr. 2** gjatë fazës së vlerësimit të ofertave për faktin që në Kërkesën nr. 2 e as të dëshmitë e kërkuara në asnjë vend nuk shënon fjalë *“listën e referencave/kontratave të realizuara, siç kërkohen në kërkesën numër 2”*.

Nga dokumentet që kemi pranuar në qasje të tenderit me datën **24.06.2026** pas vlerësimit të **pare** të ofertave dhe pas publikimit të Formularit- B58- Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues me datën **24.06.2026** – ku me kontratë ka rekomanduar që të shpërblehet OE :Prime Tours & Travel SH.P.K, shihet që OE: Prime Tours & Travel SH.P.K pas hapjes së ofertave dhe pas pranimi nga Autoriteti Kontraktues të Formularin B47- Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit kishte dërguar disa dokumente - dëshmi të lëshuar nga ProCredit Bank për qarkullimin që kishte pasur me IATA dhe Aviokompani të ndryshme, konkretisht:

- Dokumenti nga ProCredit Bank - nuk e ka të shënuar datën e lëshimit por ka të shënuar vetëm datat e periudhës së qarkullimit në mes të Prime Tours & Travel SH.P.K dhe **IATA** prej datës **01.01.2023** deri me datën **18.06.2026**.
- Dokumenti nga ProCredit Bank - nuk ka të shënuar datën e lëshimit por ka të shënuar vetëm datat e periudhës së qarkullimit në mes të Prime Tours & Travel SH.P.K dhe **WIZZAR** prej datës **01.01.2024** deri me datën **19.06.2026**.
- Dokumenti nga ProCredit Bank - nuk ka të shënuar datën e lëshimit por ka të shënuar vetëm datat e periudhës së qarkullimit në mes të Prime Tours & Travel SH.P.K dhe **SUNEXPRES** prej datës **01.01.2023** deri me datën **18.06.2026**.
- Dokumenti nga ProCredit Bank - nuk ka të shënuar datën e lëshimit por ka të shënuar vetëm datat e periudhës së qarkullimit në mes të OE:Prime Tours & Travel SH.P.K dhe **TURK EKONOMI** prej datës **01.01.2023** deri me datën **18.06.2026**.

Fatkeqësisht edhe Komisioni i vlerësimit të trete të ofertave në përbërje, Yllka Sylja, Ilirian Mekani dhe Refket Kaleshi, këto dokumente të lëshuara nga ProCredit Bank pas datës së hapjes së ofertave dhe dorëzuar nga OE:Prime Tours & Travel SH.P.K të Autoriteti Kontraktues gjithashtu pas datës së hapjes së ofertave i ka konsideruara si dokumente valide dhe bazuar në këto dokumente të dorëzuara ka rekomanduar që me kontrate të shpërblehet prape OE i pa përgjegjshëm, Prime Tours & Travel SH.P.K.

Këto veprime të zyrtareve të Autoritetit Kontraktues dhe Komisionit të vlerësimit të ofertave janë në kundërshtim të plote me nenin 72 paragrafi 3 të LPP si dhe nenit 38 paragrafi 3 dhe nenit 40 paragrafi 40.2 të RRPP 002/2024 për faktin së gjate fazës së vlerësimit të ofertave nuk munden që të ndryshojnë kriteret e përzgjedhjes dhe nuk mund të konsiderohen valide dokumentet të cilat ekzistenca e të cilave është e fiksuar para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve.

Përshkrim i nenit 40.2 të RRPP 002/2024

40.2 Tenderët e pranuar me kohë të paraqitur nga tenderuesit do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit dhe kontrata do t'i jepet tenderuesit që ka renditjen më të lartë. Kështu, autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kritere ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Bazuar në të gjitha dëshmitë që ka dërguar OE:Prime Tours & Travel SH.P.K konkretisht dokumentet e lëshuara nga ProCredit Bank dëshmojnë së këto dokumente janë të lëshuara (krijuara) pas datës së ofertimit dhe hapjes së ofertave ku asnjëra prej tyre nuk ka qene e dorëzuar së bashku me ofertën. Përkundër faktit që OE: Prime Tours & Travel SH.P.K. ka tentuar që të kamufloje dhe manipuloj me këto dokumente duke hequr nga dokumentet datën e lëshimit nga ProCredit Bank, nuk ja ka arritur qëllimit për faktin së në këto dokumente janë të shënuara datat e periudhës së qarkullimit (01.01.2024 - 19.06.2026, 01.01.2023 – 18.06.2026), që saktësisht dëshmojnë së këto dokumente nuk kane ekzistuar në datën që OE:Prime Tours & Travel SH.P.K ka ofertuar në këtë aktivitet të prokurimit, e që ka qene data 27.05.2026 dhe as ne datën e hapjes se ofertave që ka qene data 18.06.2026.

Gjithashtu këto raporte të leshura nga ProCredit Bank përmbajnë edhe transaksione pas datës së ofertimit siç janë datat 27.05.2026, 29.05.2026, 31.05.2026, 03.06.2026, 05.06.2026, 06.06.2026,07.06.2026,08.06.2026,10.06.2026,11.06.2026,12.06.2026,13.06.2026,14.06.2026, 17.06.2026, 18.06.2026 dhe 19.06.2026 — pra edhe përmbajtja u krijua pas datës së ofertimit të OE: Prime Tours & Travel SH.P.K.

Dëshmitë: Raportet e lëshuara nga ProCredit Bank

Bazuar në Formularin Standard B26- Raportin e Vlerësimit të Tenderit të rubrika - Informata shtese mbi sqarimet dhe shtojca e tenderit të tri komisionet e vleresimit të ofertave kane qene të obliguara që në kete rubrike- Informata shtese mbi sqarimet dhe shtojca e tenderit të shenojne së me cilat data kane dërguar Formularin B47 të OE: Prime Tours & Travel SH.P.K, cilat kane qene kërkesa e tyre për sqarim të tenderit, në cilën date OE: Prime Tours & Travel SH.P.K ka kthyer përgjigje dhe cilat dokumente i ka dërguar së bashku me përgjigjen.

Edhe Komisioni i Vlerësimit të trete të Ofertave në asnjë vend të Raportit të Vlerësimit të Ofertave të datës **21.07.2026 nuk kane shënuar** së me cilat data janë dërguar Formularet B47 të OE: Prime Tours & Travel SH.P.K, cilat ka qene kërkesa e tyre për sqarim të tenderit, në cilën date OE: Prime Tours & Travel SH.P.K ka kthyer përgjigje dhe cilat dokumente i ka dërguar së bashku me përgjigjen.

Mos shënimi i këtyre të dhënave të shënuara me larte në Raportin e Vlerësimit të Tenderëve shpërfaqe tendencën e komisionit të vlerësimit të ofertave për fshehjen e provave dhe dëshmive të cilat argumentojnë së OE: Prime Tours & Travel SH.P.K ka dorëzuar dokumente shtese të cilat nuk kane ekzistuar në ditën e dorëzimit të ofertës nga ana e OE: Prime Tours & Travel SH.P.K , që ka qene data **27.05.2026.**

Dëshmi – Formulari i Tenderit i OE: Prime Tours & Travel SH.P.K i datës 27.05.2026

Bazuar në nenin 72 paragrafi 3 të LPP dhe nenin 38 paragrafi 38.3 të RRPP nr. 002/2024, Autoritetit Kontraktues i lejohet që të kërkoj sqarime shtese dhe plotësim të dokumenteve vetëm ne rastet kur ekzistenca e këtyre dokumenteve është e fiksuar dhe së këto dokumente pasqyrojnë prova të mjaftueshme së kane ekzistuar para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve (në rastin konkret datën **27.05.2027** kur OE: Prime Tours & Travel SH.P.K ka ofertuar) dhe të cilat mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Përshkrim i nenit 72 paragrafi 3 të LPP

3.Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet **vetëm për dokumentet** ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Përshkrim i nenit 38 paragrafi 38.3 te RRPP

38.3 Megjithatë, lejohet qe një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkoj dhe të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë në aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, në mënyrë objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve.

Të gjitha këto pretendime ankimore - shkelje esenciale që kane bere Komisioni i Vlerësimit të ofertave dhe Zyrtaret Përgjegjës të Autoritetit Kontraktues edhe gjate fazës së vlerësimit të trete të ofertave i kemi shënuar në **Kërkesën tone për Rishqyrtim që kemi dërguar të AK me datën 25.07.2026**.

Fatkeqësisht Zyrtaret Përgjegjës të AK asnjë nga këto pretendime të cekura me larte nuk i mori për baze por prape vazhduan **me shkelje esenciale të legjislacionit primar dhe sekondar të prokurimit publik** të aplikueshëm në Republikën e Kosovës të cekura me larte në këtë Ankese.

Konstatimi i Zyrtareve të AK në Vendimin e datës 30.07.2026 për refuzim të Kërkesës tone për Rishqyrtim lidhur me pretendimin ankimor nr. 1: **citojmë:**

“ Nga formulimi i kësaj kërkesë rezulton qarte se Autoriteti Kontraktues ka kërkuar dëshmi për realizimin e qarkullimit, ndërsa askund nuk ka përcaktuar se dokumenti i paraqitur duhet të përmbajë datën e lëshimit , apo se mungesa një date të tillë e bën dokumentin të pa pranueshëm “ përfundim i citatit.

Ky konstatim jo vetëm që është qesharak, jo profesional, jo etik, diskriminues por shpërfaqë edhe tendencën e Zyrtareve Përgjegjës të AK që më çdo kusht, pa u bazuar në asnjë dispozite ligjore, ofertën e OE: Prime Tours & Travel SH.P.K ta bëjnë oferte të përgjegjshme dhe ta shpërblejnë me kontrate.

Konstatimi i Zyrtareve të AK në Vendimin e datës 30.07.2026 për refuzim të Kërkesës tone për Rishqyrtim lidhur me pretendimin ankimor nr.1: citojmë:

“ andaj të gjitha transaksionet financiare janë para datës së dorëzimit të ofertave” përfundim i citatit.

Edhe ky konstatim është qesharak, jo profesional, jo etik, diskriminues që shpërfaqë edhe tendencën e Zyrtareve Përgjegjës të AK që më çdo kusht, pa u bazuar në asnjë dispozite ligjore, ofertën e OE: Prime Tours & Travel SH.P.K.

E vërteta është krejt tjetër.

Raportet e ProCredit Bank përmbajnë edhe transaksione pas datës së ofertimit (27.05.2027) të OE: Prime Tours & Travel SH.P.K, që janë:

Transaksionet nga Prime Tours & Travel SH.P.K të IATA:

Me datën 18.06.2026 – 1 transaksion

Me datën 11.06.2026 – 2 transaksione

Me datën 05.06.2026 – 1 transaksion

Me datën 29.05.2026 – 1 transaksion

Transaksionet nga Prime Tours & Travel SH.P.K të Avio kompania WIZZAIR:

Me datën 19.06.2026 – 6 transaksione

Me datën 18.06.2026 – 4 transaksione

Me datën 17.06.2026 – 4 transaksione

Me datën 14.06.2026 – 1 transaksion

Me datën 13.06.2026 – 4 transaksione

Me datën 12.06.2026 – 2 transaksione

Me datën 11.06.2026 – 2 transaksione

Me datën 10.06.2026 – 1 transaksion

Me datën 08.06.2026 – 2 transaksion

Me datën 07.06.2026 – 7 transaksion

Me datën 06.06.2026 – 3 transaksion

Me datën 31.05.2026 – 1 transaksion

Me datën 27.05.2026 – 1 transaksion

Transaksionet nga Prime Tours & Travel SH.P.K të Avio kompania TURK EKONOMI

Me datën 03.06.2026 – 1 transaksion

Dëshmitë: Raportet e ProCredit Bank

Edhe vetë OE: **Prime Tours & Travel SH.P.K** në kronologjinë e kërkesës së tij për rishqyrtim të datës **13.07.2026**, shënon: „Kthimi i përgjigjes së letrës standarde datë: **20.06.2026**”, që dëshmon së **Raportet e ProCredit Bank** janë dërguar të AK më datën **20.06.2026** - **njëzet e katër ditë pas dorëzimit të ofertës.**

Valle cili është motivi i këtyre Zyrtareve Përgjegjës të AK që të bien deri në këtë nivel sa ti shkelin të gjitha parimet e legjislacionit të prokurimit publik dhe të gjitha parimet njerëzorë dhe profesionale duke tentuar me çdo kusht që ti shtrembërojnë faktet dhe argumentet? Për këta Zyrtar nuk po vlejka as LPP, konkretisht neni 72 dhe as RRPP 002/2024, konkretisht neni 38.3. Sipas këtyre Zyrtareve po u dashka AK me përcaktuar të kriteret e përzgjedhjes së cilat data dokumentet duhet ti kenë në rastet kur kërkojnë sqarimet e tenderit dhe vetëm atëherë paska mundësi që këto dokumente të konsiderohen si jo valide!

Zyrtaret e AK shume mire e dine së date e ofertimit për OE: Prime Tours & Travel SH.P.K, është data **27.05.2026**. Ky OE ka qene i obliguar që këto dokumente ti ketë dorëzuar së bashku me ofertën ose gjate sqarimeve të dërgoje dokumente që kane ekzistuar para ofertimit. Kështu e rregullon edhe neni **72 i LPP** dhe neni **38.3 i RRPP 002/2024**. Çdo interpretim tjetër është shkelje e këtyre dispozitave të legjislacionit të prokurimit publik.

Siç e kemi cekur edhe me larte ne këtë ankese, dokumentet- Raportet e ProCredit Bank që OE: Prime Tours & Travel SH.P.K i ka dërguar të AK gjate fazës së vlerësimit të pare të ofertave e dëshmoje së këto dokumente janë krijuar, manipuluar dhe dërguar nga OE: Prime Tours & Travel SH.P.K të AK **njëzet e katër ditë pas dorëzimit të ofertës dhe dy ditë pas datës së hapjes së ofertave.**

Se këto raporte janë te manipuluar e dëshmojnë faktet që nuk përmbajnë logo, letër kokë, emër dhe nënshkrim të zyrtarit lëshues, numër reference, datë lëshimi, as klauzolë përdorimi.

Në të njëjtën dokumentacion të aktivitetit të prokurimit është edhe Vërtetimi i Qarkullimit i lëshuar nga e njëjta bankë ProCredit Bank për kompaninë tone AS TRAVEL CLUB SH.P.K i cili i përmban të gjitha këto elementet e lartshënuara.

Prandaj bazuar në këto të dhëna të shënuar me larte sa i perket pretendimit nr.1, shume qarte shihet së edhe Komisioni i trete i Vlerësimit të ofertave dhe Zyrtaret Përgjegjës të AK, pranimin e këtyre dokumente të shënuara me larte si valide e kane bere në kundërshtim të plote me legjislacionin primar dhe sekondar të prokurimit publik të aplikueshëm në Republikën e Kosovës konkretisht në kundërshtim me nenin nenin 59 dhe nenin 72 paragrafi 3 të LPP si dhe nenin 40 dhe 38 paragrafi 38.3 të RRPP nr. 002/2024.

Pretendimi ankimor nr. 2:

Autoriteti Kontraktues- MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK në Njoftimin për Kontrate neni **III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional dhe në Dosjen e Tenderit – Fleta e të Dhënave të Tenderit(FDT) neni 9.1&9.2, të kërkesa 1 ka kërkuar:**

Kërkesat 1. Operatori ekonomik duhet të ketë së paku 3 (tre) punëtorë të kualifikuar përgjegjës për sigurimin e shërbimeve të cilët duhet të jenë të trajnuar nga Asociacioni Ndërkombëtar i Transportit Ajror (International Air Transport Association- IATA) dhe të kenë minimum 6 muaj përvojë pune.

Dëshmitë 1.a. Certifikatave diplomave ose licencave profesionale të punëtorëve të lëshuara nga Asociacioni Ndërkombëtar i Transportit Ajror (International Air Transport Association- IATA) për së paku 3 (tre) punëtorë të kualifikuar si dhe kopjet e kontratave të punës së 3 (tre) punëtorëve të kërkuar. OE mundet të aplikojnë edhe me staf që kanë para-kontrata.

Operatori Ekonomik : Prime Tours & Travel SH.P.K. të cilin Autoriteti Kontraktues e ka rekomanduar që të shpërblehet me kontrate për ta plotësuar këtë kërkesë në ofertën që ka dorëzuar përmes platformës së e-prokurimit me datën **27.05.2026** ka dorëzuar **Listën e Stafit** më emrat e **6 punëtorëve** dhe një pjesë të dëshmive të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues. Së bashku me ofertën ka dorëzuar një dokument në PDF në të cilin shënon: **Parakontrate Dorina Cakolli**. Kur të hapet ky dokument shihet së janë vetëm **dy faqe** të këtij dokumenti (prej nenit 14-24).

Në fund të faqes së dyte ka të shënuar:

I punësuar Dorina Cakolli dhe një nënshkrim si dhe Punëdhënësi- Fisnik Dragusha dhe një nënshkrim.

Në këtë dokumente prej dy faqeve (siç është i emërtuar- **Parakontrate Dorina Cakolli**), nuk është i shënuar numrin personal i punëtorit, numrin personal të punëdhënësit, Ne këto dy faqe të këtij dokumenti në asnjë vende **nuk ka të shënuar datën e krijimit dhe nënshkrimit të këtij dokumenti, numrin e aktivitetit të prokurimit , titullin e aktivitetit të prokurimit e as emrin e Autoritetit Kontraktues.**

Bazuar në pasqyrën e Trustit që është dorëzuar si bashku me ofertën me datën **27.05.2026** shihet së znj. Dorina Cakolli ka punuar në kompaninë FLY HELLO TRAVEL SH.P.K.

Dëshmia: Pjesë nga Para kontrata e Dorina Cakollit dhe Pasqyra e Trustit

Nga dokumentet që kemi pranuar nga Autoriteti Kontraktues me datën **22.07.2026** dhe **24.07.2026** kemi parë së pas dërgimit me datën **28.06.2026** të Kërkesës për Rishqyrtim nga ana e kompanisë tone AS TRAVEL CLUB SH.P.K, dhe kthimit të **lendes ne ri-vlerësim** nga Autoriteti Kontraktues kishte formuar Komisioni e **dyte për vlerësimin** e ofertave në përbërje: **Yllka Sylja, Ilirian Mekani dhe Florinda Kukalaj.**

Zyra e Prokurimit me datën **03.07.2026** kishte dërguar Formularin B47- Letër Standarde e kërkesës për sqarimin të tenderit të OE: Prime Tours & Travel SH.P.K ku në këtë kërkesë për sqarime përveç tjerash kishin shënuar, **citojmë:**

“Bazuar ne nenin 72 dhe nenin 59 te LPP-se, dhe neni 38 Sqarimi i tenderëve i Rregullores nr. 002/ 2024 për Prokurimin Publik gjate procesit te vlerësimit te tenderëve kërkojmë nga ana juaj plotësimin e dokumentacionit lidhur me kriterin:

Për kërkesën me nr. 1 të kapacitetit Teknik dhe ose professional

Ju si OE keni ofruar një listë me 6 punëtorë prej tyre 3 punëtorë me Diplomë IATA sipas kërkesës së AK.

Kontrata e punës për një prej punëtorëve (Dorina Cakolli) nuk është dorëzuar e kompletuar. Ajo është dorëzuar me ofertë te AK prej nenit 14. Nenet e para mungojnë.

Ne si AK nuk mund të vendosim andaj kërkojmë që të dorëzohet dëshmia konform kërkesës së AK”, **përfundim i citatit.**

Edhe nga të dhënat e shënuara në këtë kërkesë shume qarte **shpërfaqet tendenca** e Zyrtareve të Autoritetit Kontraktues që me çdo kusht ofertën e OE të preferuar Prime Tours & Travel SH.P.K ta bëjnë oferte të përgjegjshme.

Kërkesa e Zyrës së Prokurimit që i është dërguar OE të preferuar Prime Tours & Travel SH.P.K me datën **03.07.2026** është në kundërshtim të plote me nenin **nenin 72 paragrafi 3 të LPP** dhe nenin **38 paragrafi 38.3 të RRPP nr. 002/2024** për faktin së siç e kemi cekur edhe të **pretendimi ankimor nr.1**, Autoritetit Kontraktues i lejohet që të kërkoj sqarime shtese dhe plotësim të dokumenteve vetëm në rastet kur ekzistenca e dokumenteve është e fiksuar dhe pasqyrojnë prova të mjaftueshme së kane ekzistuar para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve dhe të cilat mund të verifikohet në mënyrë objektive që nënkupton datën **27.05.2026** për faktin së OE: Prime Tours & Travel SH.P.K ka ofertuar me datën **27.05.2026** dhe se bashku me ofertën nuk e ka dërguar te kompletuar **Para kontratën me Dorina Cakollin.**

Dokumentet të cilat krijohen nga vete Operatoret Ekonomik në rastin konkret Para kontrata e Dorina Cakollit nuk mund të fiksohet dhe të pasqyrojë prova të mjaftueshme së ka ekzistuar para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, konkretisht para dorëzimit të ofertës së OE: Prime Tours & Travel SH.P.K me datën **27.05.2026.**

OE: Prime Tours & Travel SH.P.K me rastin e ofertimit ka manipuluar kur me oferte ka dorëzuar vetëm **dy faqe** të fundit të një kontrate ndërsa në folderin që e ka dërguar e ka emërtuar **Para kontrata Dorina Cakolli.** Në asnjërën prej këtyre dy faqeve siç e cekem edhe me larte nuk shënon ne asnjë vend së është **para kontrate**, por çdo here i referohet kontratës. Mjafton ta lexosh vetëm nenin **22 dhe 23** në faqen e fundit që i ka dërguar së bashku me ofertën ku çdo here i referohet **Ligjit të punës dhe Kontratës Kolektive** që dëshmon që ky dokument nuk ka të beje fare me Para kontratë apo Kontrate për Shërbime të Veçanta.

Siç e cekem edhe me larte ne këto dy faqe në asnjë vend nuk është i shënuar numri i aktivitetit të prokurimit, titullin e kontratës, kohëzgjatjen e angazhimit dhe të dhëna tjera të cilat domosdoshmërisht duhet ti ketë një Kontrate për Shërbime te Veçanta kur angazhohet person për një aktivitet të caktuar të prokurimit.

Ne konsiderojmë së këto veprime OE: Prime Tours & Travel SH.P.K e ka bere me qellim të manipulimit për faktin së nuk ka pasur asnjë mundësi që të krijohet, nënshkruhet Kontrata për Shërbime të Veçanta-Para Kontrata me Dorina Cakollin, skanohet dhe të ngarkohet në Platformën e E-prokurimit menjëherë pas orës **3:00** të mëngjesit kur është bere publikimi i Njoftimit për Kontrate të datës **27.05.2026**.

OE: Prime Tours & Travel SH.P.K me këtë dokument dy faqesh me emër të Dorina Cakollit manipulon që prej vitit **2024** në të gjitha Autoritetet Kontraktuese ku oferton por fatkeqësisht për kundër faktit që në kemi dëshmuar së ky dokument është i manipuluar dhe i falsifikuar dhe kemi kërkuar që të verifikohet nga Autoritetet Kontraktuese dhe Organi Shqyrtues i Prokurimit ende nuk është marre ndonjë veprim konkret.

Mungesa e të dhënëve të aktivitetit të prokurimit siç janë numri i prokurimit, titulli i kontratës, emri i Autoritetit Kontraktues, emri i kopanise punëdhënëse, etj. Në dokumentin dy faqes që **OE: Prime Tours & Travel SH.P.K ka dorëzuar se bashku me ofertën, automatikisht ofertën e bëjnë të përgjegjshme** për faktin së Autoriteti Kontraktues bazuar ne legjislacionin e prokurimit publik **nuk ka pasur të drejte ligjore që të kërkoj sqarime** shtese gjate fazës së vlerësimit të ofertave për dokumente që krijohen nga vete Operatorët Ekonomik për të cilat nuk mund të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve në rastin konkret datën e ofertimit **27.05.2026**.

Bazuar në të dhënat që ka shënuar OE: Prime Tours & Travel SH.P.K në Kërkesën për Rishqyrtim shihet së OE: Prime Tours & Travel SH.P.K pas kërkesës se Autoritetit Kontraktues të datës **03.07.2026** me datën **07.07.2026**, kishte dërguar një dokument në të cilin here shënon Kantatë Pune Për Kohe të Caktuar e here Kontrate për Shërbime të Veçanta – Para kontratë me emër- **Dorina Cakolli**.

Në këtë dokument që është me emër - Dorina Cakolli që OE: Prime Tours & Travel SH.P.K ka dërguar të Autoriteti Kontraktues me datën **07.07.2026** në **nenin 5** të këtij dokumenti shënon:

” Data e marrëveshjes është më 18.06.2026”.

Dëshmi: Dokumenti që ka të shënuar emrin e Dorina Cakollit që OE: Prime Tours & Travel SH.P.K ka dërguar të Autoriteti Kontraktues me datën 07.07.2026

Data e shënuar në **nenin 5** të këtij dokumenti **“18.06.2026”** me së miri e dëshmon dhe argumenton së ky dokument **nuk ka ekzistuar** në kohen kur OE: Prime Tours & Travel SH.P.K ka ofertuar në këtë aktivitet të prokurimit e që ka qene data **27.05.2026**.

Bazuar në këto që cekem me larte shihet së **OE: Prime Tours & Travel SH.P.K nuk e plotëson as Kërkesën 1**, të Kapaciteteve Teknike dhe Profesionale për faktin së nuk ka arritur ti ketë së **paku 3 (tre)** punëtorë të kualifikuar përgjegjës për sigurimin e shërbimeve të cilët duhet të jenë të trajnuar nga **Asociacioni Ndërkombëtar i Transportit Ajror (International Air Transport Association- IATA)**.

Të gjitha këto pretendime ankimore - shkelje esenciale që kanë bere Komisioni i Vlerësimit të ofertave dhe Zyrtaret Përgjegjës të Autoritetit Kontraktues edhe gjate fazës së vlerësimit **të trete** të ofertave sa i përket këtyre pretendimit ankimor nr.2 i kemi shënuar në **Kërkesën tone për Rishqyrtim që kemi dërguar të AK me datën 25.07.2026.**

Fatkeqësisht Zyrtaret Përgjegjës të AK asnjë nga këto pretendime të cekura me larte nuk i mori për baze por prape vazhdoj **me shkelje esenciale të legjislacionit primar dhe sekondar të prokurimit publik** të aplikueshëm në Republikën e Kosovës të cekura me larte në këtë Ankese.

Konstatimi i Zyrtareve të AK në Vendimin e datës 30.07.2026 për refuzim të Kërkesës tone për Rishqyrtim lidhur me pretendimin ankimor nr. 2, **citojmë:**

“Operatori Ekonomik Prime Tours & Travel SH.P.K e ka përmbushur plotësisht këtë kërkesë. Në ofertën e tij ka dorëzuar një liste të stafit prej gjithsej 6 (gjashte) personash, të cilët janë të licencuar sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktues dhe posedojnë certifikatat profesionale të kërkuara nga IATA. Për rrjedhojë, edhe në aspektin numerik edhe në atë profesional, Operatori Ekonomik e tejkalon kërkesën minimale të përcaktuar në Dosjen e Tenderit” **përfundim i citatit.**

Ky konstatim i Zyrtareve Përgjegjës të Autoritetit Kontraktues është jo profesional, jo etik, diskriminues, i pa bazuar në fakte dhe argumente, shtrembërim i fakteve dhe argumenteve dhe i cili shpërfaqë tendencën e Zyrtareve Përgjegjës të AK që më çdo kusht, pa u bazuar në asnjë dispozite ligjore, ofertën e OE: Prime Tours & Travel SH.P.K ta bëjnë oferte të përgjegjshme dhe ta shpërblejnë me kontrate.

Është e vërtetë që OE: Prime Tours & Travel SH.P.K ka dorëzuar një liste prej 6 personave, por vetëm dy prej tyre posedojnë dokumente valide të kërkuara sipas Kërkesës nr. 1 të Kapacitetit Teknik dhe Profesional të Autoritetit Kontraktues – vetëm Besa Danca e shënuar ne nr. 2 të listës dhe Rina Osmani e shënuar në nr. 5 të listës.

Kjo përgjigje e datës 30.07.2026 është në kundërshtim me aktin e vetë AK-së — Formularin B47 të datës 03.07.2026, në të cilin Autoriteti Kontraktues ka konstatuar se nga 6 punëtorët e listuar vetëm 3 posedojnë Diplomë IATA dhe se kontrata e punës për njërin prej tyre (Dorina Cakolli) nuk ishte dorëzuar e kompletuar, duke deklaruar shprehimisht se "Ne si AK nuk mund të vendosim". Pra numri minimal prej 3 punëtorëve arrihej vetëm nëse llogaritej znj. Dorina Cakolli, dëshmia e së cilës — sipas deklaramentit të vetë AK-së — ishte e pakompletuar në momentin e hapjes së ofertave.

Për asnjërin prej katër puntoreve të tjerëve nuk i ka dorëzuar dokumente – dëshmi valide siç i ka kërkuar vete AK ne Kërkesën nr. 1.

Në nr. 1 të listës - Dorina Cakolli – mungon Kontrata për Shërbime të Veçanta valide – për arsyet e shënuara me larte.

Në nr. 3- Arlida Kushevica, nuk është dorëzuar asnjë dokument- dëshmi përveç emrit që është shënuar ne liste.

Ne nr.4 Besart Osmani – nuk është dorëzuar asnjë dokument – dëshmi që posedon Certifikate, diplome apo licence nga IATA

Ne nr. 6- Skurte Gashi – nuk është dorëzuar asnjë dokument – dëshmi që posedon Certifikate, diplome apo licence nga IATA.

Bazuar në këto fakte dhe argumente që cekem me larte shtrohet pyetja si ka mundësi që të gjithë Zyrtaret Përgjegjës të AK që kane qene pjese e procesit të këtij aktiviteti të prokurimit – Komisioni i vlerësimit të ofertave, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, Zyrtaret që kane shqyrtuar Kërkesën tone për Rishqyrtim dhe Zyrtare tjerë , të **mos i shohin të gjitha këto mangësi** në ofertën e OE: Prime Tours & Travel SH.P.K, por të konstatojnë së gjeja **jo vetëm që i plotëson kërkesën nr.1 por edhe e tejkalon.**

Konstatimi i Zyrtareve të AK në Vendimin e datës 30.07.2026 për refuzim të Kërkesës tone për Rishqyrtim lidhur me pretendimin ankimor 2, **citojmë:**

“ Për rrjedhoje, Operatori Ekonomik ka përmbushur kërkesën për kapacitet teknik dhe profesional duke paraqitur me shume se numri minimal të stafit të kërkuar , të gjithë të licencuar sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktues , ndërsa dokumentacioni i dorëzuar për znj. Dorina Cakolli, përfshire kontratën e punës, licencën dhe Pasqyrën e Trustit Pensional është e mjaftueshme për të dëshmuar përmbajtjet e kriterit.” **përfundim i citatit**

Bazuar në faktet dhe argumentet që kemi shpalosur me larte edhe ky konstatim i Zyrtareve Përgjegjës të Autoritetit Kontraktues është jo profesional, jo etik, diskriminues, i pa bazuar në fakte dhe argumente, shtrembërim i fakteve dhe argumenteve dhe i cili shpërfaqë tendencën e hapur të Zyrtareve Përgjegjës të AK që më çdo kusht, pa u bazuar në asnjë dispozite ligjore, ofertën e OE: Prime Tours & Travel SH.P.K ta bëjnë oferte të përgjegjshme dhe ta shpërblejnë me kontrate.

Këto të dhëna të shënuar me larte sa i për ketë pretendimit ankimor nr.2, shume qarte shihet së ,Komisioni i trete i Vlerësimit të ofertave dhe Zyrtaret Përgjegjës të AK gjate shqyrtimit të Kërkesës tone për Rishqyrtim të datës 25.07.2026 , pranimin e këtyre dokumenteve të shënuara me larte si valide, vlerësimin e ofertave dhe refuzimin e Kërkesës tone për Rishqyrtim e kane bere në kundërshtim të plote me legjislacionin primar dhe sekondar të prokurimit publik të aplikueshëm në Republikën e Kosovës konkretisht në kundërshtim me nenin nenin 59 dhe nenin 72 paragrafi 3 të LPP si dhe nenin 40 dhe 38 paragrafi 38.3 të RRPP nr. 002/2024.

Pretendimi ankimor nr. 3:

Autoriteti Kontraktues- MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK në Njoftimin për Kontrate neni **III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: dhe në Dosjen e Tenderit – Fleta e të Dhënave të Tenderit(FDT) neni 9.1&9.2, te kërkesa 3 ka kërkuar:**

Kërkesa 3. Një Menaxher i kontratës.

Dëshmia- 3.Vendimi për caktimin e Menaxherit të kontratës i vulosur dhe i nënshkruar nga OE

„Menaxheri duhet të ketë së paku pese vite përvojë pune për menaxhim operator ne fushen e turizmit duke ja bashkangjitur edhe CV-në me të gjitha të dhënat e nënshkruar nga personi i caktuar, po ashtu duhet të ketë Kontratën ose para- kontratën me emër të projektit.

Operatori Ekonomik : Prime Tours & Travel SH.P.K. të cilin Autoriteti Kontraktues e ka rekomanduar që të shpërblehet me kontrate për ta plotësuar këtë kërkesë në ofertën që ka dorëzuar përmes platformës së e-prokurimit me datën **27.05.2026 ka dorëzuar Vendimin për Caktimin e Menaxherit të Kontratës.**

Në këtë vendim emri i Autoritetit Kontraktues është shënuar **krejtësisht gabim**, ka shënuar “**Emri i Institucionit:MKRS**”

Titulli i kontratës (projektit) është shënuar krejtësisht gabim: Shërbimet e transportit ajror-bileta për nevojat e MKRS-së” ndërsa në Njoftimin për Kontrate dhe Dosje të Tenderit emri i kontratës (projektit) është shënuar:” **Shërbimet e transportit ajror – bileta për nevojat e MKT-së dhe Institucioneve Vartëse”**

Në këtë vendim fare nuk është shënuar numri i aktivitetit të prokurimit.

Dëshmia- Vendimi për Caktimin e Menaxherit të Kontratës i datës 27.05.2026

Të gjitha **këto mangësi** që janë identifikuar në këtë dokument, këtë vendim - dokument e bëjnë të pavlefshëm dhe OE: Prime Tours & Travel SH.P.K as për se afërmi nuk e plotëson as **Kërkesën nr. 3 të Kapaciteteve Teknike dhe Profesionale që ka të beje me Vendimin e Menaxherit te Kontratës.**

Të gjitha këto pretendime ankimore - shkelje esenciale që kane bere Komisioni i Vlerësimit të ofertave dhe Zyrtaret Përgjegjës të Autoritetit Kontraktues edhe gjate fazës së vlerësimit **të trete** të ofertave sa i

për këtë pretendimit ankimor nr.3 i kemi shënuar në **Kërkesën tone për Rishqyrtim që kemi dërguar të AK me datën 25.07.2026.**

Fatkeqësisht Zyrtaret Përgjegjës të AK asnjë nga këto pretendime të cekura me larte sa i për këtë pretendimit ankimor nr.3 nuk i mori për baze por prape vazhdoj **me shkelje esenciale të legjislacionit primar dhe sekondar të prokurimit publik** të aplikueshëm në Republikën e Kosovës të cekura me larte në këtë Ankese.

Konstatimi i Zyrtareve të AK në Vendimin e datës 30.07.2026 për refuzim të Kërkesës tone për Rishqyrtim lidhur me pretendimin ankimor 2, **citojmë:**

“ Pasi që në asnjë detaj te Kërkesës së Autoritetit Kontraktues nuk precizohet që ne Caktimin e Vendimit për Menaxher të Kontratës duhet të jete i paraqitur Numri i Prokurimit. Pra, kërkesa thekson ne emër të projektit dhe jo ne numër të prokurimit.” **përfundim i citatit**

Bazuar në faktet dhe argumentet që kemi shpalosur me larte edhe ky konstatim i Zyrtareve Përgjegjës të Autoritetit Kontraktues sa i për këtë pretendimit ankimor nr. 3 është jo profesional, jo etik, diskriminues, i pa bazuar në fakte dhe argumente, shtrembërim i fakteve dhe argumenteve dhe i cili shpërfaqë tendencën e hapur të Zyrtareve Përgjegjës të AK që më çdo kusht, pa u bazuar në asnjë dispozite ligjore, ofertën e OE: Prime Tours & Travel SH.P.K ta bëjnë oferte të përgjegjshme dhe ta shpërblejnë me kontrate.

I vetmi dokument që përmban emër projekti është Vendimi i datës **27.05.2026**. Në të, emri i Autoritetit Kontraktues është shënuar „MKRS”, ndërsa titulli i projektit „Shërbimet e transportit ajror – bileta për nevojat e MKRS-së” — pa komponentin „dhe Institucioneve Vartëse”. Objekti i kontratës është përcaktuar në Fletën e të Dhënave të Tenderit dhe në emërtimin e publikuar si „Shërbimet e transportit ajror – bileta për nevojat e MKT-së dhe Institucioneve Vartëse”. Dokumenti nuk përmban as numrin e aktivitetit të prokurimit. Emri i projektit, pra, nuk është dhënë as i plotë as i saktë — dhe institucionet vartëse nuk janë element dytësor, sepse përcaktojnë shtrirjen e shërbimit.

Vendimi i kundërshtuar i përgjigjet vetëm njërit krah — atij të numrit të prokurimit — duke përfunduar se „kërkesa thekson një emër të projektit dhe jo numër të prokurimit”. Me këtë, Autoriteti Kontraktues e pranon vetë se kriteri lidhet me emrin e projektit; pikërisht atë emër asnjë nga dy dokumentet nuk e përmban.

Edhe ne kërkesën për Rishqyrtim shume mire i kemi cekur të gjitha faktet dhe argumentet të cilat Vendimin e Menaxherit që OE: Prime Tours & Travel SH.P.K ka dërguar së bashku me ofertën as për se afërmi nuk i plotëson kërkesën e AK për faktin se ka mangësi substanciale dhe nuk mund të konsiderohet valid.

Pretendimi ankimor nr. 4:

Autoriteti Kontraktues – MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK me datën 26.05.2026 në platformën e e-prokurimit ka publikuar Përshkrimin e Çmimeve.

Në Përshkrimin e Çmimeve të nr. 1- **Bileta Aeroplani** sipas përshkrimit në ANEX 1 – kolona 3- **Sasia e përafërt e biletave/36 muaj - 2000 cope**, të kolona 4 ka shënuar - **Çmimi njësi me të gjitha taksat e aplikueshme 355** ndërsa në kolonën 5 ka shënuar **Çmimi total me të gjitha taksat e aplikueshme 710,000.00** ndërsa në nr. 2- kolona 1 ka shënuar-**Tarifa e shërbimit (service charge) e ofruar nga Operatori Ekonomik i shprehur ne Euro.**

Autoriteti Kontraktues në Njoftimin për Kontrate, në Dosjes e Tenderit e as në Përshkrimin e Çmimeve në asnjë vende nuk ka shënuar së **Tarifa e shërbimit (service charge) mund të shënohet me tre shifra pas presjes dhjetore.**

Poshtë tabelës së Përshkrimit të Çmimeve të Sqarimi ka shënuar, citojmë

“Vlera e biletës prej € 355.00 është një vlerë e paragjykuar që shërben vetëm për nevojat e vlerësimit të tenderit dhe nuk përcakton çmimin real të kontratës. Çmimi real do të krijohet përgjatë zbatimit të kontratës nga sistemi kompjuterik i rezervimit AMADEUS, GALILO, SABRE, apo sistem tjetër të barasvlershëm ose sisteme online. Kontrata do të bazohet në vlerën financiare”, **përfundim i citatit.**

Ky sqarim dëshmon së çmimi për njësi i një bilete duhet të jete me dy (2) numra pas presës dhjetore.

Bazuar në nenin 17.11 të RRPP nr. 002/2024 për Prokurim Publik të gjitha çmimet e specifikuar në tender duhet të deklarohen në Euro (€). Çmimi i ofertuar lejohet që të shënohet me maksimum dy (2) numra pas pikës dhjetore. Nëse OE ofron çmimin për njësi me TVSH me me shume se dy (2) numra pas pikës dhjetore, oferta e tille do të konsiderohet e papërgjegjshme. Në rast se AK lejon çmime me më shume se (2) numra pas pikës dhjetore, atëherë AK një informatë të tillë duhet t’a përcaktoj në dosjen e tenderit dhe duhet të përdorë Listën e çmimeve jo-standarde.

Përshkrim i nenit 17 paragrafi 17.11 i RRPP Nr. 002/2024

17.11 Të gjitha çmimet e specifikuar në tender duhet të deklarohen në Euro (€). Çmimi i ofertuar lejohet që të shënohet me maksimum dy (2) numra pas pikës dhjetore. Nëse OE ofron çmimin për njësi me TVSH me me shume se dy (2) numra pas pikës dhjetore, oferta e tille do të konsiderohet e papërgjegjshme. Në rast se AK lejon çmime me më shume se (2) numra pas pikës dhjetore, atëherë AK një informatë të tillë duhet t’a përcaktoj në dosjen e tenderit dhe duhet të përdorë Listën e çmimeve jo-standarde.

Në Përshkrimin e Çmimeve Autoriteti Kontraktues ka shënuar edhe këtë sqarim për fituesin e kontratës-**citojmë:**

“Fituesi i kësaj kontrate është i obliguar që faturës duhet ti bashkëngjitet edhe printimi i biletës elektronike me çmimi të lëshuar nga sistemi kompjuterik i rezervimit AMADEUS, GALILO, SABRE, apo sistem tjetër të barasvlershëm, kur rezervimi behet ne web faqet e avikompanive kontraktuesi duhet te bashkëngjisë edhe një “screenshot” te momentit te rezervimit te biletës, duke përfshirë edhe rezervimin e biletës se bashku me maskën e biletës. Gjithashtu duhet të vendoset kamera para kompjuterit që të xhirohet e gjithë procedura e rezervimit të biletës, tek një kompjuter në zyrën e kontraktuesit dhe të gjitha ato xhirime duhet të ruhen nga kontraktuesi dhe secila video duhet të jetë e qartë dhe e pastër ku mund të verifikohet çmimi, datat dhe te gjitha të dhënat gjate rezervimit te biletës, ka te drejtën që vlerën financiare të vendos tre numra pas presjes dhjetore.” **mbarim i citatit**

Shume qarte shihet se ky sqarim te cilin e ka shenuar Autoriteti Kontraktues ska te beje fare me Tarifën e shërbimit apo me çmimin për njësi ashtu siç e rregullon neni 17 paragrafi 17.11 i RRPP Nr. 002/2024. Gjithashtu ky sqarim në asnjë vende nuk i referohet çmimit të Tarifës së shërbimit (service charge) e as çmimit për njësi por i referohet vlerës financiare që krijohet nga sistemi AMADEUS.

OE: “Prime Tours & Travel” SH.P.K të cilin Autoriteti Kontraktues ka rekomanduar që të shpërblehet me kontrate ka ofertuar të Tarifa e shërbimit (service charge) me tre(3)–numra pas presës dhjetore 0.001 €.

Dëshmia: Përshkrimi i Çmimeve dhe Oferta financiare e OE: “Prime Tours & Travel” SH.P.K

Siç e cekem edhe me larte Autoriteti Kontraktues në asnjë dokument të këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka specifikuar që është e lejueshme ofertimi me tre numra pas presës dhjetore, përkundrazi në Sqarimet që ka shënuar në Përshkrimin e Çmimeve të shembulli i çmimit të biletës ka shënuar 355.00 që dëshmon se është çmim për njësi me dy numra pas presës dhjetore.

Këto fakte dhe argumente të cekura me larte automatikisht ofertën e OE: “Prime Tours & Travel” SH.P.K e bëjnë të pa përgjegjshme për faktin se ka ofertuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik dhe kërkesat e Autoritetit Kontraktues.

Për Informimin tuaj:

Shembuj i Listës së Çmimeve kur Autoriteti Kontraktues nuk lejon që të ofertohej me tarifa të shërbimit apo premiumit me me shume se dy numra pas presës dhjetore:

Autoriteti Kontraktues : MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK

Numri i Prokurimit: 207-23-10336-2-1-1

Titulli i Kontratës: Shërbimet e transportit ajror – bileta për nevojat e MKRS-së dhe Institucioneve Vartëse

LISTA E ÇMIMEVE					
	PËRSHKRIMI I OFERTËS FINANCIARE	Njësia	Sasia e përafërt e biletave/36 muaj	Çmimi njësi me të gjitha taksat e aplikueshme	Çmimi total me të gjitha taksat e aplikueshme
0	1	2	3	4	5 = (3x4)
1	Bileta Aeroplani sipas përshkrimit në ANAKS 1	copë	2000	355.00	710,000.00
2	Tarifa e shërbimit (service charge) e ofruar nga Operatori Ekonomik i shprehur ne Euro	copë	2000		-
VLERA TOTALE E OFERTES (VLERA E SHENUAR NE NUMRIN RENDOR 1 PLUS VLERA E SHENUAR NE NUMRIN RENDOR 2)					710,000.00

Sqarim:*

Vlera e biletës prej € 355.00 është një vlerë e paragjykuar që shërben vetëm për nevojat e vlerësimit të tenderit dhe nuk përcakton çmimin real të kontratës. Çmimi real do të krijohet përgjatë zbatimit të kontratës nga sistemi kompjuterik i rezervimit AMADEUS, GALILO, SABRE, apo sistem tjetër të barasvlershëm ose sisteme online. Kontrata do të bazohet në sasi.

*Tarifa e shërbimit duhet dhënë në kolonën Nr. 4 të rreshtit Nr.2 me vetëm dy shifra pas

Vëmendje:

•Çmimi i biletave krijohet nga çmimi që gjenerohet nga sistemi kompjuterik i rezervimit AMADEUS, GALILO, SABRE, apo sistem tjetër të barasvlershëm apo nga çmimet në kohe reale në web faqet e aviokompanive që rezervimin e ofrojnë online plus tarifa e shërbimit (service charge) sipas shumës fikse të ofruar në tenderin tuaj të paraqitur në numrin rendor 2 të Listës së Çmimeve.

•Fituesi i kësaj kontrate është i obliguar që faturës duhet të bashkëngjitet edhe printimi i biletës elektronike me çmimi të lëshuar nga sistemi kompjuterik i rezervimit AMADEUS, GALILO, SABRE, apo sistem tjetër të barasvlershëm, kur rezervimi bëhet në web faqet e aviokompanive kontraktuesi duhet të bashkëngjisë edhe një “screenshot” të momentit të rezervimit të biletës, duke përfshirë edhe rezervimin e biletës së bashku me maskën e biletës. Gjithashtu duhet të vendoset kamera para kompjuterit që të xhirohet e gjithë procedura e rezervimit të biletës, tek një kompjuter në zyrën e kontraktuesit dhe të gjitha ato xhirime duhet të ruhen nga kontraktuesi dhe secila video duhet të jetë e qartë dhe e pastër ku mund të verifikohet çmimi, datat dhe të gjitha të dhënat gjatë rezervimit të biletës.

•Tarifa e shërbimit të shprehur në shumë fikse dhe e paraqitur në numrin rendor 2 të tabelës së çmimeve, gjatë realizimit të kontratës është e pa ndryshuar dhe çdo herë aplikohet në vlerën totale të çmimit variabël të biletës të lëshuar nga sistemi kompjuterik i rezervimit ose nga rezervimet online.

•Nëse rastësisht Autoritetet Kontraktuese pranon dy e më shumë oferta të përgjegjshme me çmime të njëjta, oferta e përgjegjshme e cila është dorëzuar e para do të shpërblehet me kontratë.

Autoriteti Kontraktues : MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME

Numri i Prokurimit: 216-26-3818-2-1-1

Titulli i Kontratës: Shërbimet e transportit ajror

LISTA E ÇMIMEVE

	PËRSHKRIMI I OFERTËS FINANCIARE	Njësia	Sasia e përafërt e biletave/12 muaj	Çmimi njësi DDP– i planifikuar*	Çmimi total i planifikuar me TVSH
0	1	2	3	4	5 = (3x4)
1	Bileta Aeroplani sipas përshkrimit në ANEKS 1	copë	1400	355.00	497,000.00
2	Tarifa e shërbimit (service charge) e ofruar nga Operatori Ekonomik i shprehur ne Euro	copë	1400		-
VLERA TOTALE E OFERTES (VLERA E SHENUAR NE NUMRIN RENDOR 1 PLUS VLERA E SHENUAR NE NUMRIN RENDOR 2)					

Sqarim:*Vlera e biletës prej € 355.00 është një vlerë e paragjykuar që shërben vetëm për nevojat e vlerësimit të tenderit dhe nuk përcakton çmimin real të kontratës. Çmimi real do të krijohet përgjatë zbatimit të kontratës nga sistemi kompjuterik i rezervimit AMADEUS, GALILO, SABRE, apo sistem tjetër të barasvlershëm ose sisteme online. Kontrata do te bazohet në sasi.

*Tarifa e shërbimit duhet dhënë në kolonën Nr. 4 të rreshtit Nr.2 me vetëm dy shifra pas presjes dhjetore, (p.sh. € 0.00). Çdo shifër me më shumë s dy (2) numra pas presjes dhjetore nuk do të merret për bazë në llogaritjen e vlerës së ofertës.

Autoriteti Kontraktues : KUVENDI I KOSOVËS

Numri i Prokurimit: 101-26-3767-2-1-1

Titulli i Kontratës: Shërbime të udhëtimit me aeroplan - bileta

Titulli: Shërbime të udhëtimit me aeroplan - bileta Nr. i Prokurimit: 101-26-3767-2-1-1 dhe Nr. i Brendshëm: KU101 26 022 211					
PËRSHKRIMI I ÇMIMIT					
Nr.	Përshkrimi	Njësia matëse	Sasia e përfaqërt për 24 muaj	Çmimi njësi DDP – i planifikuar	Çmim total i planifikuar
			<i>a</i>	<i>b</i>	<i>c = a x b</i>
1	Bileta Aeroplani	Copë	600	490.00	294,000.00
2	Tarifa e shërbimit (service charge) e ofruar nga Operatori Ekonomik e shprehur në Euro	Copë	600		
VLERA TOTALE E OFERTËS (Vlera e shënuar në numrin rendor 1 plus vlera e shënuar në numrin rendor 2)					294,000.00
Vërejtje: *Vlera e biletës prej 490.00 euro është vlerë referuese dhe shërben vetëm për kalkulimin e çmimit dhe për nevojat e vlerësimit të tenderit. Kjo vlerë nuk përcakton çmimin real të kontratës, pasi çmimi real i biletës do të krijohet përgjatë zbatimit të kontratës, në çmimin që në momentin e rezervimit gjenerohet nga sistemi kompjuterik i rezervimit AMADEUS, GALILEO, SABRE apo sistem tjetër i barasvlershëm/ekuivalent, ose nga çmimet momentale në uebfaqet zyrtare të aviokompanive. Tarifa e shërbimit duhet të jepet me dy numra pas presjes dhjetore (p.sh. 2.55 €). Oferta që përmban çmime me më shumë se dy numra pas presjes dhjetore do të refuzohet në pajtim me LPP-në.					
Shënim: Operatorë ekonomikë duhet t'i japin çmimet reale të tregut për pozicion dhe në total për furnizimet e kryera dhe shërbimet e ofruara. Çmimet jo-normalisht të ulëta dhe çmimet më të larta se çmimet reale të tregut do të trajtohen në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik.					

Autoriteti Kontraktues : ZYRA E PRESIDENTIT TË REPUBLIKES SE KOSOVËS

Numri i Prokurimit: 102-24-10844-2-2-1

Titulli i Kontratës: Shërbime të transportit ajror - bileta

Titulli: Shërbime të transportit ajror - bileta Nr. i Prokurimit: 102-24-10844-2-2-1					
PËRSHKRIMI I ÇMIMIT					
Nr.	Përshkrimi	Njësia matëse	Sasia e përfaqësuar për 24 muaj	Çmimi njësi DDP – i planifikuar	Çmim total i planifikuar
			<i>a</i>	<i>b</i>	<i>c = a x b</i>
1	Bileta Aeroplani	Copë	300	390	117,000.00
1	Tarifa e shërbimit (service charge) e ofruar nga Operatori Ekonomik e shprehur në Euro	Copë	300		
VLERA TOTALE E OFERTËS (Vlera e shënuar në numrin rendor 1 plus vlera e shënuar në numrin rendor 2)					
Vërejtje: *Vlera e biletës prej 390 euro është një vlerë që shërben vetëm për kalkulim të çmimit dhe çmimi total do të përdoret vetëm për nevojat e vlerësimit të tenderit dhe nuk përcakton çmimin real të kontratës pasi që çmimi do të krijohet përgjatë zbatimit të kontratës nga çmimet që do të procedohen nga sistemi kompjuterik i rezervimit AMADEUS, GALILO, SABRE, apo sistem tjetër të barasvlershëm apo sisteme online. *Tarifa e shërbimit duhet dhënë vetëm me dy numra pas presjes dhjetore, (p.sh. 2.55 €). Çdo numër i shënuar pas dy (2) numrave të presjes dhjetore nuk do të merret për bazë në llogaritje të vlerës së ofertës.					
Shënim: Operatorë ekonomikë duhet t'i japin çmimet reale të tregut për pozicion dhe në total për furnizimet e kryera dhe shërbimet e ofruara. Çmimet jo-normalisht të ulëta dhe çmimet më të larta se çmimet reale të tregut do të trajtohen në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik.					

Autoriteti Kontraktues : ZYRA E KRYEMINISTRIT

Numri i Prokurimit: ZK104-25-1842-2-1-1

Titulli i Kontratës: “Shërbime të transportit ajror”

Nr.	PËRSHKRIMI I OFERTËS FINANCIARE	Njësia	Sasia e përafërt e biletave/36 muaj	Çmimi njësi DDP– i planifikuar*	Çmimi total i planifikuar
1	Bileta Aeroplani sipas përshkrimit në ANAKS 1	copë	700	490.00	343,000.00
2	Tarifa e shërbimit (service charge) e ofruar nga Operatori Ekonomik i shprehur ne Euro	copë	700		-
				TOTAL:	343,000.00
	Sqarim:*Vlera e biletës prej € 490.00 është një vlerë e paragjykuar që shërben vetëm për nevojat e vlerësimit të tenderit dhe nuk përcakton çmimin real të kontratës. Çmimi real do të krijohet përgjatë zbatimit të kontratës nga sistemi kompjuterik i rezervimit AMADEUS, GALILO, SABRE, apo sistem tjetër të barasvlershëm ose sisteme online. Kontrata do te bazohet në sasi. *Tarifa e shërbimit duhet dhënë në kolonën F4 të rreshtit Nr.2 me vetëm dy shifra pas presjes dhjetore, (p.sh. € 0.00).				

Shembuj i Listës së Çmimeve kur Autoriteti Kontraktues lejon që të ofertohet me tarifa të shërbimit apo premiume me me shume së dy numra pas presës dhjetore:

Autoriteti Kontraktues : Agjencia Qendrore e Prokurimit

Numri i Prokurimit: 201/26300-26-2068-1-1-1

Titulli i Kontratës: Furnizim me Karburante

LISTA E ÇMIMEVE

NR.	Pershkrimi	DIESEL – sipas Aneksi 1 specifikimet teknike te detyrueshme	BENZIN – sipas Aneksi 1 specifikimet teknike te detyrueshme
1	Berza mesatare mujore CIF Med (Genova/Lavera Ton/\$	720.4500	704.9500
2	Kursi mesatar mujor \$/euro (variabile)	0.8458	0.8458
3	Çmimi i tonit ne Euro (3=1x2)	609.3221	596.2129
4	Shndërrimi i tonit ne litër (fiks)	1,191	1,368
5	Çmimi për litër ne euro (5=3/4)	0.5116	0.4358
6	Akciza për litër	0.3600	0.3850
7	GJITHSEJ (7=5+6)	0.8716	0.8208
8*	Premiumi i kompanisë për 1 litër *		
9	Gjithsej çmimi me Premium (9=7+8)	0.8716	0.8208
10	TVSH 18% / litër (10=9x18%)	0.1569	0.1477
11	Çmimi për litër për faturim (9+10)	1.0285	0.9686
12	Totali I litrave	4,320,000	210,000
13	Cmimi total I ofertes (13=11x12)	4,443,095.86	203,401.22

14	AD-Blue/Liter		
15	Cmimi per një Liter AD-Blue		
16	Totali I Cmimit per AD-Blue		
17	Totali		

Vërejtje/Sqarim: Ofertuesi duhet të plotësojë vetëm kolonën 8 dhe 15 dhe cmimi total do të llogaritet sipas formulës - Totali duhet të vendoset si cmim total i ofertës (17CD)

- Premiumi për litër lejohet të shënohet me maksimum katër (4) numra pas presës dhjetore. Çdo numër i shënuar pas numrit të katërt (4) nuk do të merret për bazë në llogaritje të vlerës së ofertës.
- Premiumi për litër do të jetë i pandryshuar gjatë tërë afatit të vlefshmërisë së kontratës dhe do të llogaritet sipas premimeve të dhëna nga Operatori Ekonomik për llojet e karburanteve në Pjesa LISTA E ÇMIMEVE - kolona – 8 si dhe cmimi për AD-Blue do të jetë i pandryshueshëm/fiks - Kolona 15
- Çmimet për faturim të KARBURANTEVE do të llogariten nga Agjencia Qendrore e Prokurimit në baza mujore dhe do të formohen sipas të dhënave të pasqyruara në Tabelë që është formuar sipas Aneksit 10 të dosjes së tenderit
- Bazë për vendosjen e vlerave në tabelë është çmimi sipas berzës (formulës) të Muajit Shkurt 2026 (duke rumbullaksuar vlerat me 4 numra pas presës dhjetore

Bazuar në të gjitha këto Lista të Çmimeve të Autoriteteve Kontraktuese të paraqitura me lartë dhe të gjitha Listave të Çmimeve të Autoriteteve Kontraktuese të Republikës së Kosovës përfshirë edhe Autoritetin Kontraktues - MINISTRIA E KULTURËS RS DHE ÇJK (në aktivitetin që ka zhvilluar në vitin 2023), çdo here gjatë zhvillimit të aktivitetit të prokurimit për Shërbime të Transportit ajror-Furnizim me bilete aeroplani, për pjesën që ka të bëjë me numrat pas presës dhjetore ju kanë referuar Tarifes së shërbimit (service charge).

Të gjitha këto pretendime ankimore - shkelje esenciale që kanë bërë Komisioni i Vlerësimit të ofertave dhe Zyrtaret Përgjegjës të Autoritetit Kontraktues edhe gjatë fazës së vlerësimit të trete të ofertave sa i përket këtyre pretendimeve ankimore nr.4 i kemi shënuar në **Kërkesën tone për Rishqyrtim që kemi dërguar të AK me datën 25.07.2026.**

Fatkeqësisht Zyrtaret Përgjegjës të AK asnjë nga këto fakte dhe pretendime të cekura me lartë nuk i mori për bazë por prapë vazhdoj **me shkelje esenciale të legjislacionit primar dhe sekondar të prokurimit publik** të aplikueshëm në Republikën e Kosovës të cekura me lartë në këtë Ankese.

Konstatimi i Zyrtareve të AK në Vendimin e datës 30.07.2026 për refuzim të Kërkesës tone për Rishqyrtim lidhur me pretendimin ankimor 4, citojmë:

“ Në rastin konkret , Autoriteti Kontraktues ka vepruar pikërisht në këtë mënyrë. Në dokumentacionin e tenderit dhe në Paramaset (Listën e Çmimeve Jo-standarde) ka parapare shprehimisht mundësinë e

paraqitjes se vlerave me tre (3) numra pas presës dhjetore, duke përdorur formularin përkatës jo-standard, në përputhje me kërkesat e nenit 17.11 të RRPP”- përfundim i citatit.

Ky konstatim i Zyrtareve të Autoritetit Kontraktues është skandaloz në kundërshtim të plote me legjislacionin e prokurimit publik , pikërisht në kundërshtim me nenin 17.11 të RRPP Nr.002/2024, për faktin që cekem me lartë se ky nen i referohet çmimeve për njësi e kurrësi vlerave asht siq pretendojnë Zyrtaret e Autoritetit Kontraktues.

Janë vete Zyrtaret e Autoritetit Kontraktues që pas aprovimit të Kërkesës tone të pare për Rishqyrtim sipas vendimit të AK të datës 08.07.2026 kane konstatuar se për shkak të OE: “Prime Tours & Travel” SH.P.K ka ofertuar me tre numra pas pres dhjetore është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit dhe e shpërblyer me kontrate kompaninë tone As Trave Club SH.P.K.

Dëshmi: Vendim i datës 08.07.2026 dhe Letra Standarde për Eliminimin e OE:“Prime Tours & Travel” SH.P.K.

Pretendimi ankimor nr. 5:

Autoriteti Kontraktues ka bere shkelje esenciale të nenit 63 paragrafi 63.1.3 pika (a) të RRPP Nr.002/2024 për faktin se dy here radhazi ka aprovuar Kërkesat për Rishqyrtim, lenden e ka kthyer në Ri vlerësim por asnjë here nuk e ka publikuar Formularin B58 për anulim të vendimit paraprak për dhënie të kontratës ashtu siç e kërkon neni 63 paragrafi 63.1.3 pika (a) të RRPP Nr.002/2024.

Përshkrim i nenit 63 paragrafi 63.1.3 pika (a) të RRPP Nr.002/2024

a. Kurdo që miratimi i kërkesës ndërlidhet me vendimin e AK për dhënie të kontratës (sipas paragrafit 63.1.2), pezullimi i tillë do të përfundojë para skadimit të një periudhe prej të paktën 10 ditë kalendarike nga data e publikimit të vendimit të AK. Pas vendimit për miratim të kërkesës, AK do të përdorë formularin B58 për publikim të anulimit të vendimit paraprak dhe vendimin për dhënie/shpërblyer të kontratës ta kthejë në ri-vlerësim.

Konstatimi i Zyrtareve të AK në Vendimin e datës 30.07.2026 për refuzim të Kërkesës tone për Rishqyrtim lidhur me pretendimin ankimor nr. 5, citojmë:

“Të gjitha veprimet procedurale të ndërmarra nga Autoriteti Kontraktues, përfshirë pezullimin e aktivitetit të prokurimit, shqyrtimin e kërkesës për rishqyrtim , vendimet për miratim apo refuzim të tyre si dhe procesin e ri vlerësimit të ofertave janë ndërmarre në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm dhe brenda kompetencave të Autoritetit Kontraktues” përfundim i citatit.

Ky konstatim i Zyrtareve Përgjegjës të Autoritetit Kontraktues është jo profesional, jo etik, diskriminues, i pa bazuar në fakte dhe argumente, shtrembërim i fakteve dhe argumenteve.

Se sa profesional kane qene Zyrtaret e AK gjate pezullimit të aktivitetit të prokurimit e dëshmon vete fakti që në Vendimin për pezullim të aktivitetit të prokurimit të datës 27.07.2026 kane shënuar të dhënat e një aktiviteti të prokurimit që e kane zhvilluar gjate vitit 2025 dhe për shkak të

shkeljeve esenciale të legjislacionit të prokurimit publik, Organi Shqyrtues ka marre vendim që të anulohet ende pa i hapur ofertat, dhe ky aktivitet i prokurimit është anuluar në mars të vitit 2026.

Dëshmi: Vendimi mbi Pezullimin e aktivitetit të Prokurimit i datës 27.07.2026

Ndërsa së sa jo profesional dhe jo zbatues të legjislacionit të prokurimit publik, besoj që i kemi dëshmuar me faktet dhe argumentet që kemi shënuar me lartë në këtë ankese.

Bazuar në të gjitha faktet dhe argumente të shënuara me lartë shihet që Autoriteti Kontraktues – MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK edhe vlerësimin e trete të ofertave dhe rekomandimin që me kontratë të shpërblehet OE: “Prime Tours & Travel” SH.P.K, e ka bërë në kundërshtim të plotë me legjislacionin primar dhe sekondar të prokurimit publik të aplikueshëm në Republikën e Kosovës, konkretisht nenit 59 dhe 72 të LPP si dhe shkelje të nenit 38, 40 dhe 63 të RREGULLORËS NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK

Prandaj duke u bazuar në faktet dhe argumentet e shënuara me lartë, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i OSHP – së, që Ankesën tone ta konsiderojë si të bazuar, të marre vendim për anulimin e Vendimit të AK të datës 21.07.2026 dhe lenden ta kthejë në Ri-vlerësim.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Kompania jone është dëmtuar për shpenzimet e bëra me rastin e përgatitjes së Ofertës, shpenzimet e përgatitjes së dy Kërkesave për Ri shqyrtim, shpenzimet e përgatitjes së Ankesës për OSHP dhe fitimet e pritura.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

1. Njoftimi për Kontratë: 27.05.2026
2. Dosja e Tenderit: 26.05.2026
3. Lista e Përshkrimit të Çmimeve: 26.05.2026
4. Sqarime për Operatoret Ekonomik: 15.06.2026
5. Procesverbal i Hapjes së Tenderëve: 18.06.2026
6. Formularin B47- Letër Standarde e Kërkesës për Sqarime të Tenderit për OE: Prime Tours & Travel SH.P.K -18.06.2026

7. Kërkesë për Plotësim të Dokumenteve për OE: Prime Tours & Travel SH.P.K – Deshmitë nga Gjykata dhe Administrata Tatimore : 23.06.2026
8. Raporti i Vlerësimit të **parë të Ofertave** ku është rekomanduar që të shpërblehet OE :Prime Tours & Travel SH.P.K: 24.06.2026
9. B58- Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – ku me kontrate ka rekomanduar që të shpërblehet OE :Prime Tours & Travel SH.P.K. 24.06.2026
10. Kërkesa për qasje në dokumentet e tenderit të dërguar nga OE : AS TRAVEL CLUB SH.P.K të Autoritetit Kontraktues:24.06.2026
11. Lejimi i qasjes nga Autoriteti Kontraktues me datën 24.06.2026
12. Kërkesë për Rishqyrtim e dërguar nga OE : AS TRAVEL CLUB SH.P: 28.06.2026
13. Vendim për Pezullim të aktivitetit të prokurimit:29.06.2026
14. Vendimi i AK- për pranim - Pjesërisht të Bazuar të Kërkesës për Rishqyrtim të OE : AS TRAVEL CLUB SH.P :30.06.2026
15. Raporti i Vlerësimit të **dytë të Ofertave** ku është rekomanduar që me kontrate të shpërblehet OE: AS TRAVEL CLUB SH.P.K ka datën e shënuar **01.07.2026** ndërsa është nënshkruar nga komisioni i vlerësimit dhe aprovuar nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit me datën **08.07.2026**
16. B58- Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – ku me kontrate ka rekomanduar që të shpërblehet OE : AS TRAVEL CLUB SH.P.K: 08.07.2026
17. Kërkesë për Rishqyrtim e dërguar nga OE :Prime Tours & Travel SH.P.K. 13.07.2026
18. Vendimi i AK- për pranim të Bazuar të Kërkesës për Rishqyrtim të OE :Prime Tours & Travel SH.P.K: 15.07.2026
19. Raporti i Vlerësimit të **trete të Ofertave** ku është rekomanduar që të shpërblehet OE :Prime Tours & Travel SH.P.K: 21.07.2026
20. B58- Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – pas vlerësimit të trete të Ofertave ku është rekomanduar që me kontrate të shpërblehet OE :Prime Tours & Travel SH.P.K. 21.07.2026
21. Kërkesa për qasje në dokumentet e tenderit të dërguar nga OE : AS TRAVEL CLUB SH.P.K të Autoritetit Kontraktues:21.07.2026
22. Lejimi i qasjes nga Autoriteti Kontraktues me datën 22.07.2026
23. Kërkesa për qasje në dokumentet shtese te tenderit të dërguar nga OE : AS TRAVEL CLUB SH.P.K të Autoritetit Kontraktues:24.07.2026
24. Lejimi i qasjes nga Autoriteti Kontraktues me datën 24.07.2026
25. Kërkesë për Rishqyrtim: 25.07.2026
26. Vendim për Pezullim të aktivitetit të prokurimit:29.06.2026
27. Njoftim për OE për shtyrje të afatit për shqyrtim të Kërkesës për Rishqyrtim:28.07.2026
28. Vendimi i AK- për refuzim si të pa bazuar të Kërkesës tone për Rishqyrtim - OE : AS TRAVEL CLUB SH.P.K :30.07.2026
29. Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 te LPP-së;

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E KULTURËS DHE TURIZMIT

Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit

18/06/2026

MINISTRIA E KULTURËS DHE TURIZMIT

Prime Tours & Travel SH.P.K., Edit Durham, 21, Prishtine, Kosovë

Nr i prokurimit	207-26-4023-2-1-1
Nr i brendshëm	207-26-047-2-1-1

Titulli: Shërbimet e transportit ajror – bileta për nevojat e MKT-së dhe Institucioneve Vartëse

I/e nderuar(a) **Prime Tours & Travel SH.P.K., Edit Durham, 21, Prishtine, Kosovë**

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim “LPP”.

Për të vlerësuar tenderin e juaj në mënyrë të duhur, ne kërkojmë që të siguronit sqarimin e tenderit të juaj si në vijim:

*Bazuar ne dokumentacionin qe keni ofruar ne dosjen e tenderit, me konkretisht ne listën e referencave/kontratave te realizuara, sic kërkohen ne kërkesën numër 2, poashtu dhe dëshmia qe kërkohet: **2. Kopje e dëshmive të pagesave (Raport të transfereve) që janë bërë nga operatori ekonomik për blerjen e biletave nga avion kompanitë përkatëse apo sistemi kompjuterik i rezervimit ose burime apo qfarëdo dëshmie tjetër që dëshmojnë lehtësisht qarkullimin e kërkuar. Me kete kërkojmë qe te plotësoni dokumentacionin sipas tabelës se Referencave/kontratave ashtu sic kërkohen tek dëshmia e kërkuar dokumentare.***

Si pasojë e nevojave imediate nga ana e MKT dhe institucioneve vartëse për këtë shërbim kërkojmë nga ana e juaj sa me shpejt që është e mundur dorëzimin e këtyre dokumentacioneve. Në rast që ky dokumentacion nuk plotësohet brenda 5 ditëve, AK-MKT llogaritet që keni hequr dorë nga aplikimi. Dokumentacionin duhet të dërgoni në emailin zyrtarë ose të ngritni në platformën elektronike e-prokurimi.

Me respekt,
Komisioni vlerësues
Ju falënderojmë paraprakisht,

Me respekt,

Prokurimi: 207-26-4023-2-1-1

Nr i brendshëm:

Tituli: Shërbimet e transportit ajror – bileta për nevojat e MKT-së dhe Institucioneve Vartëse

1 Shërbimet e transportit ajror – bileta për nevojat e MKT-së dhe Institucioneve Vartëse

Kodi i tenderit: 207-26-4023-2-1-1

Data: 27.05.2026

Lista e dokumenteve të tenderit mbështetëse

Nr.	Dokument
1.	DOKUMENTAT 1.zip
2.	DOKUMENTAT 2.zip
3.	20260527035624544.pdf

Përshkrimi i çmimeve

Nr	Emërtimi i grupit	Dokumenti
1.	Shërbimet e transportit ajror – bileta për nevojat e MKT-së dhe Institucioneve Vartëse	Paramasa (1).xlsx

Pjesët e tenderit që do të dorëzohen ndaras:

N.A

AUTORITETI KONTRAKTUES

MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK, NENA TEREZE NR 35, -, PRISHTINË,

Zyrtari përgjegjes i prokurimit:

Nr i Prokurimit: 207-26-4023-2-1-1

OPERATOR EKONOMIK:

Emri i kompanisë dhe adresa e plote: **Prime Tours & Travel SH.P.K., Edit Durham, 21, Prishtine, Kosovë**

E-mail: **FISNIK@PRIMETRAVEL-KS.COM**

Personi kontaktues: **FISNIK DRAGUSHA**

Telefoni: **+383 48 48 68 68/**

Faxi: **/**

Numri fiskal: **811982215**

Grup i operatorëve ekonomik (nëse aplikohet):

FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: 207-26-4023-2-1-1

Titulli i kontratës: Shërbimet e transportit ajror – bileta për nevojat e MKT-së dhe Institucioneve Vartëse

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.

2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

1 Shërbimet e transportit ajror – bileta për nevojat e MKT-së dhe Institucioneve Vartëse

3. Çmimi total i tenderit është:

710,002.00 EUR

Dhe në fjalë [shëno çmimin e tenderit në fjalë **Euro**]

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: **90** nga data finale për dorëzim të tenderëve.

5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës

6. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet] si partner në konsorcium të udhëhequr nga [shëno emrin e udhëheqësit]. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës.

7. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK

8. Theksojmë që Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar të vazhdojë me këtë ftesë dhe që e

rezervon të drejtën për të dhënë vetëm një pjesë të kontratës. Ai nuk do të shkaktojë detyrime ndaj nesh nëse e bën këtë.

Informacion në lidhje me nënkontraktorët

Emri dhe adresa e nënkontraktorit	Numri fiskal - nënkontraktorë	Përshkrimi i pjesës së kontratës që do të nënkontraktohet	Pjesa vlera të nënkontraktohet	Përqindja e kontratës që do të nënkontraktohet (%)

punës,

3) Pushim javor në kohëzgjatje prej njëzet e katër (24) orë pandërprerë,

4) Pushim javor prej së paku katër (4) javë,

5) I punësuar i cili përkundër masave mbrojtëse nuk mund të mbrohet nga ndikimet e jashtme, ka të drejtë në pushim shtesë vjetor në kohëzgjatje prej tridhjet (30) ditësh pune për vitin kalendarik.

6) Nëna me fëmijë deri në tri (3) vjeç, prindi vetëushqyes dhe personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë në pushim vjetor shtesë edhe për dy (2) ditë tjera.

Neni 14

I punësuar i cili për herë të parë themelon marrëdhënie pune ose i cili nuk ka ndërprerje më tepër se pesë (5) ditë pune, ka të drejtën e shfrytëzimit të pushimit vjetor pas gjashtë (6) muajve të punës së pandërprerë.

Neni 15

I punësuar ka të drejtë së paku 1,5 ditë të pushimit, për çdo muaj të vitit kalendarik të kaluar në punë, nëse:

1) Në vitin kalendarik në të cilin për herë të parë ka themeluar marrëdhënie pune, nuk i ka gjashtë (6) muaj të punës të pandërprerë,

2) Në vitin kalendarik nuk e ka fituar të drejtën për shfrytëzimin e pushimit vjetor për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

Neni 16

I punësuar është përgjegjës për kompenzimin e dëmit për punën ose në lidhje me punën, nëse me qëllimose nga pakujdesia i ka shkaktuar dëme punëdhënësit.

I punësuar është përgjegjës edhe për kompenzimin e dëmit, nëse me fajin e tij i ka shkaktuar dëm palës së tretë, dëm për të cilin punëdhënësi e ka kompenzuar.

Neni 17

Të punësuarit i ndërprehet marrëdhënia e punës nga punëdhënësi, nëse:

1) Ndërprerja e tillë arsyetohet për arsye ekonomike, teknike ose organizative,

2) I punësuar nuk është më i aftë të kryej detyrat e punës,

3) Në rastet e rënda të sjelljes së keqe të të punësuarit,

4) Për shkak të mospërmbyshjes së knaqëshme të detyrave të punës dhe

5) Për rastet e tjera të cilat janë përcaktuar në Ligjin e punës.

Neni 18

Punëdhënësi obligohet të sigurojë dhe zbatojë mjetet dhe masat e mbrojtjes në punë, sipas legjislacionit në fuqi. I punësuar është i detyruar t'iu përmbahet masave të caktuara të mbrojtjes në punë.

Neni 19

Punëdhënësi obligohet t'i paguajë kontributet për skemat pensionale të obligueshme dhe skemat e tjera të

përcaktuara me ligj.

Neni 20

Punëdhënësi dhe i punësuar i pranojnë të gjitha të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e caktuara me Ligj, me Kontratën kolektive dhe me këtë kontratë.

Neni 21

Për kontestet eventuale të moszbatimit të kësaj kontrate, palët kontraktuese e pranojnë kompetencën e gjykatës komunale.

Neni 22

Secila palë mundet ta shkëpusë këtë kontratë në mënyrë të njëanshme, sipas kushteve dhe rasteve të caktuara me Ligj dhe me kontratë kolektive.

Neni 23

Në asnjë rast, dispozitat e kësaj kontrate nuk mund të jenë më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësin, se dispozitat e Ligjit të punës ose të kontratës kolektive, për sa i përket të drejtave dhe kushteve nga marrëdhënia juridike e punës.

Për të drejtat dhe detyrimet të cilat nuk janë përcaktuar me këtë kontratë, zbatohen drejtpërdrejtë dispozitat e Ligjit të punës dhe të Kontratës kolektive.

Neni 24

Pas njoftimit me përmbajtjen e kontratës, kjo kontratë u nënshkrua në 2 kopje autentike, nga të cilat, secilës palë i mbeten nga 1 kopje.

I Punesuari:


DORINA ÇAKOLLI

Punedhenesi:


FISHIK DRAGUSHA






DORINA ÇAKOLLI
ABDYLL FRASHËRI 27
PRISHTINË

LËVIZJET GJATË PERIUDHËS

Vlera në fillim	€ 2,714.72
Kontributet	€ 505.56
Transferet	€ 0.00
Tërheqjet	€ 0.00
Kthimi në investim	€ 39.15
Vlera në fund	€ 3,259.43

PËRBËRJA E MJETEVE MË 15.08.2023

Portfolio	Njësitë	Çmimi për njësi	Bilanci
Standard	1,978.1047	€ 1.647754	€ 3,259.43
			€ 3,259.43



Kontribute €3,003.86 Fitim €255.57

KONTRIBUTET

Data	Periudha	Përshkrimi	I punësuar	Punëdhënësi	Gjithsej
10.01.2023	12-2022	FLY HELLO TRAVEL SH.P.K.	€ 22.12	€ 22.12	€ 44.24
06.02.2023	01-2023	FLY HELLO TRAVEL SH.P.K.	€ 22.12	€ 22.12	€ 44.24
13.03.2023	01-2023	FLY HELLO TRAVEL SH.P.K. (Shtesë)	€ 5.82	€ 5.82	€ 11.64
13.03.2023	02-2023	FLY HELLO TRAVEL SH.P.K.	€ 27.94	€ 27.94	€ 55.88
12.04.2023	03-2023	FLY HELLO TRAVEL SH.P.K.	€ 27.94	€ 27.94	€ 55.88
16.05.2023	04-2023	FLY HELLO TRAVEL SH.P.K.	€ 36.71	€ 36.71	€ 73.42
01.06.2023	05-2023	FLY HELLO TRAVEL SH.P.K.	€ 36.71	€ 36.71	€ 73.42
19.07.2023	06-2023	FLY HELLO TRAVEL SH.P.K.	€ 36.71	€ 36.71	€ 73.42
10.08.2023	07-2023	FLY HELLO TRAVEL SH.P.K.	€ 36.71	€ 36.71	€ 73.42
			€ 252.78	€ 252.78	€ 505.56





DIPLOMA

awarded to

Dorina Cakolli

who passed

Foundation in Travel and Tourism with Amadeus

Montreal, Canada, September 2016

Alexandre de Juniac
Director General and CEO
International Air Transport Association



Në bazë të nenit 10, paragrafi 2, pikat 2.1 dhe 2.2 dhe nenit 11 të ligjit të punës 03/L-212, i shpallur në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, më datë 01.12.2010, Punëdhënësi dhe i Punësuari, sisubjekte të marrëdhënies Juridike të punës, lidhin:

KONTRATË PUNE

(PËR KOHË TË CAKTUAR)

KONTRAT PER SHERBIME TE VEQANTA- PARAKONTRATE

Për: MINISTRIA E KULTURËS DHE TURIZMIT

Nr. i Prokurimit1	207-26-4023-2-1-1
-------------------	-------------------

Titulli: Shërbimet e transportit ajror – bileta për nevojat e MKT-së dhe Institucioneve Vartëse

Neni 1

Me këtë kontratë, PRIME TOURS & TRAVEL SHPK me seli: Sheshi Edit Durham No 21, me NRF: 811982215 dheNRB: 811982215 që e përfaqëson Fisnik Dragusha (në tekstin në vijim: Punëdhënësi), lidh kontratë pune me

DORINA ÇAKOLLI, me numër personal 1170955281, me banim në Rr. Rezhep Mala, no 10, Prishtinë, që posedon kualifikimin! LARTE, në tekstin në vijim i Punësuari.

Neni 2

I Punësuari caktohet në vendin e punës: KESHILLTAR UDHETIMESH .

Përshkrimi i detyrave të punës: Detyrat/Pergjegjesite: -Procesimi i rezervimeve te biletave dhe paketa turistike, udhetime dhe produkteve tjera turistike-Procesimi i biletave dhe kuponave (voucherave) si dhe pagesave te tyre- Procesimi i refundimeve dhe ndryshimeve-Lajmerimi i udhetareve ne rast te ndryshimit te orarit ose produktit.

Neni 3

I punësuari do t'i kryejë punët në subjektin afarist PRIME TOURS & TRAVEL SHPK me seli: Sheshi Edit Durham No 21.

Neni 4

I Punësuari themelon marrëdhënie pune në kohë të caktuar, duke filluar MINISTRIA E KULTURËS DHE TURIZMIT nga data e nenshkrimit te kontrates deri te perfundoj kontrata

Neni 5

Data e marrëveshjes është më 18.06.2026

Në rast se i punësuari nuk e fillon punën ditën e caktuar sipas kësaj kontrate të punës, do të konsiderohet senuk ka themeluar marrëdhënie pune, përveç nëse është penguar të fillojë punën për shkaqe të arsyeshme.

Neni 6

Puna provuese e të punësuarit zgjat deri më: 90 Ditë. Gjatë periudhës provuese të punës, punëdhënësi dhe i punësuar, mund ta ndërpresin marrëdhënien e punës, me njoftim paraprak prej shtatë (7) ditësh.

Neni 7

I punësuarit themelon marrëdhënie pune me orar të plotë. Orari ditor i punës është 8 orë punë në ditë, ndërsa orari javor i punës është 40 orë.

Neni 8

Të punësuarit i caktohet paga bazë për punën të cilën e kryen për punëdhënësin, në lartësi prej 450 €bruto, e cila paguhet së paku një herë në muaj dhe nuk mund të jetë më e ulët se paga minimale.

Neni 9

I punësuarit ka të drejtë në pagë shtesë në përqindje të pagës bazë:

- 1) 20% në orët për kujdestari,
- 2) 30% në orët për punë gjatë natës,
- 3) 30% në orët për punë jashtë orarit,
- 4) 50% në orët për punë gjatë ditëve të festave dhe
- 5) 50% në orët për punë gjatë fundjavës.

Neni 10

I punësuarit ka të drejtë në kompensim të pagës pa u angazhuar në punë, në rastet si në vijim:

- 1) Gjatë ditëve të festave në të cilat nuk punohet,
- 2) Gjatë kohës së shfrytëzimit të pushimit vjetor,
- 3) Gjatë aftësimit dhe përsosjes profesionale për të cilën është dërguar dhe
- 4) Gjatë ushtrimit të funksioneve publike për të cilat nuk paguhet.

Neni 11

I punësuarit ka të drejtë në kompensim të pushimit mjekësor të pagës bazë, prej:

- 1) 100% në rast të shfrytëzimit të pushimit mjekësor të rregullt, mbi bazën deri në 20 ditë pune brenda një viti,
- 2) 70% në rast të shfrytëzimit të pushimit mjekësor si pasojë e lëndimit në punë ose sëmundjes profesionale e cila ndërlikohet me kryerjen e punëve dhe shërbimeve për punëdhënësin, në kohëzgjatje prej 10 deri në 90 ditë pune.

Neni 12

I punësuarit ka të drejtë në kompensim të shpenzimeve gjatë kohës së kaluar në udhëtim zyrtar jashtë vendit, në lartësi prej: PaPercaktuar

Neni 13

I punësuarit ka të drejtë në pushim dhe atë:

- 1) Pushim gjatë ditës së punës në kohëzgjatje prej së paku 30 minutave në përputhje me organizimin e orarit të punës së punëdhënësit,
- 2) Pushim ditor në kohëzgjatje prej së paku 12 orë pandërprerë, midis dy (2) ditëve të njëpasnjëshme të

punës,

3) Pushim javor në kohëzgjatje prej njëzet e katër (24) orë pandërprerë,

4) Pushim javor prej së paku katër (4) javë,

5) I punësuar i cili përkundër masave mbrojtëse nuk mund të mbrohet nga ndikimet e jashtme, ka të drejtë në pushim shtesë vjetor në kohëzgjatje prej tridhjet (30) ditësh pune për vitin kalendarik.

6) Nëna me fëmijë deri në tri (3) vjeç, prindi vetëushqyes dhe personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë në pushim vjetor shtesë edhe për dy (2) ditë tjera.

Neni 14

I punësuar i cili për herë të parë themelon marrëdhënie pune ose i cili nuk ka ndërprerje më tepër se pesë (5) ditë pune, ka të drejtën e shfrytëzimit të pushimit vjetor pas gjashtë (6) muajve të punës së pandërprerë.

Neni 15

I punësuar ka të drejtë së paku 1,5 ditë të pushimit, për çdo muaj të vitit kalendarik të kaluar në punë, nëse:

1) Në vitin kalendarik në të cilin për herë të parë ka themeluar marrëdhënie pune, nuk i ka gjashtë (6) muaj të punës të pandërprerë,

2) Në vitin kalendarik nuk e ka fituar të drejtën për shfrytëzimin e pushimit vjetor për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

Neni 16

I punësuar është përgjegjës për kompenzimin e dëmit për punën ose në lidhje me punën, nëse me qëllimose nga pakujdesia i ka shkaktuar dëme punëdhënësit.

I punësuar është përgjegjës edhe për kompenzimin e dëmit, nëse me fajin e tij i ka shkaktuar dëm palës së tretë, dëm për të cilin punëdhënësi e ka kompenzuar.

Neni 17

Të punësuarit i ndërprehet marrëdhënia e punës nga punëdhënësi, nëse:

1) Ndërprerja e tillë arsyetohet për arsye ekonomike, teknike ose organizative,

2) I punësuar nuk është më i aftë të kryej detyrat e punës,

3) Në rastet e rënda të sjelljes së keqe të të punësuarit,

4) Për shkak të mospërmbyshjes së knaqëshme të detyrave të punës dhe

5) Për rastet e tjera të cilat janë përcaktuar në Ligjin e punës.

Neni 18

Punëdhënësi obligohet të sigurojë dhe zbatojë mjetet dhe masat e mbrojtjes në punë, sipas legjislacionit në fuqi. I punësuar është i detyruar t'iu përmbahet masave të caktuara të mbrojtjes në punë.

Neni 19

Punëdhënësi obligohet t'i paguajë kontributet për skemat pensionale të obligueshme dhe skemat e tjera të

përcaktuara me ligj.

Neni 20

Punëdhënësi dhe i punësuar i pranojnë të gjitha të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e caktuara me Ligj, me Kontratën kolektive dhe me këtë kontratë.

Neni 21

Për kontestet eventuale të moszbatimit të kësaj kontrate, palët kontraktuese e pranojnë kompetencën e gjykatës komunale.

Neni 22

